



dogana.shqiptare



Dogana Shqiptare

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE

Newsletter | Korrik 2025

ADMINISTRATA DOGANORE REALIZON 9.1% MË SHUMË TË ARDHURA NË KORRIK



Administrata Doganore ka përmbyllur muajin korrik me një realizim prej 23,2 milionë lekësh, ose 9.1% më shumë se korriku i një viti më parë.

Mallrat e akcizës shënuan rritje të dukshme, me:

- **+5,200 ton karburant**
- **+58 ton cigare**
- **+60 ton kafe**
- **+200 ton birrë**

krahasuar me korrikun 2024.

Për periudhën janar-korrik 2025 janë arkëtuar **137 miliardë lekë**, me një tejkalim plani dhe një **rritje prej 4.3%** krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Edhe pse kursi i këmbimit të euros dhe dollarit solli një ndikim negativ prej **5 miliardë lekësh**, pa këtë efekt, të ardhurat do të arrinin në **142 miliardë lekë** – një realizim **4%** mbi planin dhe **8.2%** më shumë se 2024.

Në fokus qëndrojnë mallrat e akcizës, që në 7-mujorin e parë të vitit kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm:

- **+50,000 ton karburant**
- **+154 ton cigare**
- **+162 ton kafe**
- **+4,700 ton birrë**

Këto rezultate reflektojnë përpjekjet e pandërprera për përmirësim dhe kontroll efektiv, si dhe besimin në rritje të operatorëve ekonomikë.

➡ DOGANA MORINË-VËRMICË, NJË NGA SHEMBUJT MË TË SUKSESSHËM TË BASHKËPUNIMIT MES SHQIPËRISË DHE KOSOVËS

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, sëbashku me Ministrin e Financave, Petrit Malaj, Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve të Kosovës, Hekuran Murati dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave të Kosovës, Agron Llugaliu vizituan degën doganore Morinë-Vërmicë, një nga pikat më të rëndësishme doganore mes Shqipërisë dhe Kosovës.

Drejtori i Doganave, Gazheli vlerësoi se procedurat e përsheptuara dhe pika unike One Stop Shop në Morinë kanë ndikuar në rritjen e volumit tregtar mes dy vendeve dhe të fluksit të pasagjerëve. Ministri Malaj vlerësoi se ndër vite bashkëpunimi mes dy vendeve tona ka qenë i qëndrueshëm dhe gjithnjë në rritje, ndërsa rezultate konkrete dhe të prekshme janë shënuar në shumë sektorë.



Nga ana e tij, ministri Hekuran Murati theksoi se lehtësitë sa i përket procedurave dhe ulja e kostove janë ndjerë nga ana e bizneseve dhe tregtarëve, çka ka ndikuar në rritjen e shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve tona. Ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës vlerësoi se falë lehtësimit të procedurave është arritur që të ulen kostot financiare dhe koha e pritjes.

DREJTORI I DOGANAVE VIZITON DEGËN DOGANORE TË BLLATËS

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave vizitoi degën doganore të Bllatës, një nga pikat që po njeh rritje të ndjeshme të fluksit të udhëtarëve, sidomos pas hapjes së Rrugës së Arbrit.

Vetëm në 24 orë përgjatë këtij sezoni janë regjistruar **5,640 hyrje-dalje** qytetarësh dhe **mbi 2,500 mjete**, një tregues i qartë i intensifikimit të lëvizjes në këtë segment.

Për t'iu përgjigjur këtij fluksi, është në proces edhe një projekt për zgjerimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e infrastrukturës së degës doganore të Bllatës.



➡ MINISTRI MALAJ DHE DREJTORI GAZHELI INSPEKTOJNË DOGANËN RINAS: FOKUS TE PËRSHEPTIMI I SHËRBIMEVE DHE ZBATIMI I PROCEDURAVE

Ministri i Financave, Petrit Malaj, së bashku me drejtorin e Përgjithshëm të Doganave, Genti Gazheli, inspektuan degën doganore në Aeroportin "Nënë Tereza", në kuadër të masave për përballimin e fluksit të udhëtarëve gjatë sezonit turistik. Ministri Malaj theksoi rëndësinë e procesimit të shpejtë të pasagjerëve, duke garantuar njëkohësisht zbatimin me përgjegjësi të procedurave doganore.

Nga ana e tij, drejtori Gazheli deklaroi se dogana e Rinasit është në gatishmëri të plotë, me shërbim 24/7 dhe me kapacitete të shtuara për të përballuar rritjen e ndjeshme të fluksit. "Etika dhe cilësia e shërbimit janë prioritet absolut," u shpreh ai, duke shtuar se fluksi ka arritur **mbi 44 mijë pasagjerë** në ditë dhe afro **250 fluturime**.



➡ VIZITË PUNE NË DOGANËN E QAFË BOTËS

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave zhvilloi një vizitë pune Qafë Botë, ku punonjësit doganorë po përballeshin me fluksin e shtuar të udhëtarëve që karakterizon sezonin turistik.



Në kushtet kur pala greke nuk po operon me kapacitet të plotë, janë dhënë udhëzime që udhëtarët të orientohen edhe drejt pikave të tjera kufitare, si Dogana e Kakavijës, si dhe ajo e Tre Urave në Përmet, për të shmangur pritjet dhe radhët e gjata.

Dogana shqiptare mbetet e angazhuar për të siguruar një shërbim të shpejtë dhe efikas për qytetarët dhe turistët që hyjnë në vendin tonë.

➡ DREJTORI I DOGANAVE TAKIM ME DREJTORIN E AUTORITETIT PORTUAL Durrës

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, zhvilloi një takim me Drejtorin e Autoritetit Portual Durrës, Kreshnik Bajraktari, ku u theksua bashkëpunimi i ngushtë ndërinstitucional për të garantuar shërbim cilësor ndaj qytetarëve dhe bizneseve.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua koordinimit për mbarëvajtjen e punës në terminalin e kontejnerëve, ku vit pas viti është rritur ndjeshëm volumi i punës dhe rëndësia strategjike në zinxhirin e furnizimit. Pavarësisht ditës së javës, apo ngarkesës së sezonit strukturat doganore dhe ato portuale vijnë punën me përkushtim maksimal.



➡ DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE NË PIKAT KUFITARE TË MURIQANIT DHE HANIT TË HOTIT



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, vizitimi i pikave kufitare të Muriqanit dhe Hanit të Hotit për të ndjekur nga afër mbarrëvajtjen e punës dhe për të garantuar një shërbim sa më efikas për udhëtarët.

Gjatë vizitës, ai u takua me punonjësit e Administratës Doganore në terren, duke vlerësuar angazhimin e tyre dhe duke theksuar rëndësinë e një shërbimi të shpejtë, profesional dhe me integritet në këto ditë me fluks të lartë, ku mbi **15 mijë udhëtarë** hyjnë çdo ditë përmes këtyre pikave kufitare.

Mesazhi ishte i qartë, të garantohet një përvojë sa më e mirë për qytetarët dhe turistët që hyjnë në Shqipëri, duke ruajtur njëkohësisht standardet e sigurisë dhe kontrollit kufitar! Administrata Doganore mbetet në gatishmëri të plotë për të menaxhuar me efikasitet lëvizjen ndërkufitare dhe për të ofruar një pritje dinjitoze për të gjithë vizitorët që zgjedhin vendin tonë këtë verë.

➡ AUTORITETET DOGANORE SEKUESTROJNË MBI 5 TON PIJE FRESKUESE TË FALSIFIKUARA

Dega e Doganës Durrës sekuestroi **616 koli me pije freskuese “Lemon Soda Dr Fruit”**, të dyshuara për shkelje të së drejtës së pronësisë intelektuale, pasi mbanin mbishkrimin “Lemon with Soda” të ngjashëm me markën e regjistruar “Lemon Soda”, me përfaqësues ekskluziv “Eurolab Internacional Grup shpk”.

Pas këqyrjes nga Drejtoria e Mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale dhe përfaqësuesit ligjor të markës, u vendos konfiskimi dhe asgjësimi i mallit me peshë **5297 kg**. ADSH vijon angazhimin për mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe shëndetit publik.



➡ TAKIM NË UNCTAD MBI SISTEMIN ASYCUDA

Drejtori i Doganave, Genti Gazheli, zhvilloi një takim të rëndësishëm mbi përmirësimet më të fundit të sistemit doganor **ASYCUDA**, një platformë e avancuar që përdoret nga **mbi 100 vende**, përfshirë Shqipërinë. Ky takim vjen në një moment kyç për Administratën Doganore Shqiptare, në kuadër të sfidave për anëtarësimin në Bashkimin Europian dhe nevojës për modernizim të plotë të sistemeve të IT.

Gjatë diskutimeve me përfaqësuesit e UNCTAD u theksua harmonizimi me standardet e BE, rritja e transparencës dhe efikasitetit në procedurat doganore, si dhe ndërveprimi me sisteme të tjera. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mbetet e angazhuar për të ecur hap pas hapi me zhvillimet teknologjike globale, duke ndërtuar një administratë moderne, transparente dhe të sigurt, në shërbim të tregtisë dhe integritetit europian.



➡ PORTI I DURRËSIT, TAKIM ME OPERATORËT E TRANSPORTIT

Administrata Doganore e Durrësit mori pjesë në një takim pune me përfaqësues të linjave kryesore të kontejnerëve, strukturave portuale dhe autoriteteve policore, me qëllim evidentimin dhe adresimin e problematikave që lidhen me fluksin në rritje të përpunimit të kontejnerëve në Portin e Durrësit, sidomos gjatë sezonit veror. Gjatë takimit, Dogana Shqiptare shprehu mbështetje ndaj operatorëve privatë dhe kompanive të transportit në shqetësimet e ngritura prej tyre.

AU theksua rëndësia e koordinimit institucional dhe u nënvizua bashkëpunimi i ngushtë me Autoritetin Portual dhe strukturat e Policisë, si një element kyç për funksionimin sa më të rregullt dhe efikas të procesit doganor.

Palët dakordësuan disa masa konkrete për të përmirësuar performancën operacionale në port dhe për të lehtësuar fluksin e përpunimit të kontejnerëve, duke synuar rritjen e konkurrueshmërisë së Portit të Durrësit në nivel rajonal.



➡ DREJTORIA E DOGANAVE FTON BIZNESIN NË PYETËSORIN ERADHËS PËR PËRMIRËSIMIN E MËTEJSHËM TË SHËRBIMEVE DOGANORE

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave fton bizneset të japin mendimin e tyre përmes pyetësorit më të fundit, për të përmirësuar më tej shërbimet doganore! Zëri juaj ndihmon për një administratë doganore më të hapur, moderne dhe në funksion të tregtisë së ndershme!

Ky proces është pjesë e angazhimit të Doganës Shqiptare për të përmbushur standardet e Bashkimit Europian dhe për të avancuar integrimin në Kapitullin 29, Bashkimi Doganor.



Plotësoni pyetësorin këtu:

<https://dogana.gov.al/d/171/219/0/1370/drejtoria-e-pergjithshme-e-doganave-ften-biznesin-ne-pyetesorin-e-radhes-per-permiresimin-e-metejshem-te-sherbimeve-doganore-publikuar-dt-18072025>

➡ APLIKO PËR STATUSIN E OPERATORIT EKONOMIK TË AUTORIZUAR

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave me vizionin për modernizimin e shërbimeve nëpërmjet digjitalizimit, në kuadër të thjeshtimit të procedurave dhe lehtësimeve doganore, fton bizneset të aplikojnë për statusin e **Operatorit Ekonomik të Autorizuar (OEA)**.

Gjatë një vizite studimore të CEFTA-s mbajtur në Bruksel, si dhe në formatin online, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nën cilësinë e kryesimit të Nënkomitetit për Doganat dhe Rregullat e origjinës, prezantoi Programin e Punës para kryetarëve të të gjitha strukturave të CEFTA-s. Prioritetet e Nënkomitetit për Doganat dhe Rregullat e Origjinës në mandatin e kryesimit nga Doganat Shqiptare kanë në fokus Operatorët Ekonomikë të Autorizuar, lehtësimin e tregtisë elektronike, bashkëpunimin me organet tatimore, përmirësimin e mëtejshëm të procedurave doganore, etj.

A jeni një biznes me besueshmëri dhe standarde të larta?

Aplikoni për statusin e Operatorit Ekonomik të Autorizuar (OEA)

- lehtësira doganore
- trajtim prioritar
- përfaqësim dinjitoz në tregun rajonal dhe europian

Më shumë info dogana.gov.al